



KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Nr. 199 Prot.

Tiranë, më 03 10 / 2025

LËNDA: Relacion Semestral

Viti Akademik 2024 – 2025 (Sem II.)

DREJTUAR: Rektorit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"

Prof. Dr. Gjokë ULDEDAJ

PËR DIJENI: Dekanit të Fakultetit Ekonomik

Prof. Dr. Halit Xhafa

Dekanes së Fakultetit të Drejtësisë

Prof. Asoc. PhD Enida BOZHEKU

Dekanit të Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit

Prof. Dr. Vejsel RIZVANOLLI

Drejtuesit të Kolegjit Profesional të Lartë

Prof. Dr. Abdul SINANI

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "Qiriazi" bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe në përputhje me plani vjetor 2024-2025 ka hartuar, aprovuar dhe realizuar marrjen e të dhënave dhe përpunuar të dhënat nga pedagogët mbi raportet semestral të lëndëve.

Msc. (Dr. në proces) Sara ULDEDAJ (Drejtuese e NJSBC)

Dr. Stavri BELLO

(Anëtar)

Msc.(Dr. në proces) Denisa Cani

(Anëtar)

Msc.(Dr. në proces) Luana Harizaj

(Anëtar)

Student, Msc. Anxhel Rrushi

(Anëtar)

HYRJE

Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri synon një qasje sistematike dhe metodologjike të qartë rreth procesit dhe rezultatit, për të siguruar efikasitet në arritjet dhe në proceset e përcaktuara nga misioni institucional. Një qasje e tillë përfshin dy elementë kryesorë:

- 1. Sigurimi i cilësisë** – i referohet proceseve të ndërmarra nga institucioni. Monitorimi dhe sigurimi i cilësisë duhet të garantojnë që sistemet të zhvillohen dhe të respektohen në mënyrë të tillë që rezultatet të jenë në cilësinë e pritur.
- 2. Kontrolli i cilësisë** - merret me rezultatet. Kontrolli i cilësisë është një qasje e bazuar në produkt. Ai kontrollon nëse rezultatet plotësojnë kërkesat e pritura të cilësisë.

Në varësi të rezultateve, ndërmerren dhe veprime të përshtatshme korrigjuese nga personeli i kontrollit të cilësisë. Çdo proces dhe nënproces brenda mësimdhënies dhe të nxënies duhet të menaxhohet përmes metodës së menaxhimit të cilësisë **PDCA (Plan, Do, Control, Act)**.

P (të planifikojë) – grumbullimin e të dhënave për të identifikuar dhe përcaktuar çështjet / problemet që kanë nevojë për përmirësim dhe për të gjetur mënyrat për t'i arritur ato.

D (të bëjë) – zbatimin e planit duke përdorur një simulim të drejtuar, një testim në grup, etj.

C (të kontrollojë) – analizimin e rezultateve për të parë nëse ekziston një marrëveshje e mirë midis qëllimeve origjinale dhe çfarë është arritur faktikisht; të bëjë ndryshime nëse është e nevojshme.

A (të veprojë) – sipas planit dhe të vazhdojë punën e mëtejshme hap pas hapi në varësi të rezultatit të nxjerrë nga kontrolli në shkallë të gjerë.

Të gjitha aktivitetet në lidhje me sigurimin e cilësisë në institucionin tonë respektojnë qëllimin dhe misionin nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së sigurimit të cilësisë.

**Parimet kryesore operacionale
të Sistemit të Brendshëm të
Sigurimit të Cilësisë në KUQ**

- Sigurimi i cilësisë së sistemit, proceseve dhe aktiviteteve është formuar dhe përforcuar nga një numër parimesh bazë, mbështetur mbi Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Ligjin Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
- Parimet dhe standardet e përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, Neni 103, janë si më poshtë vijon:
 - ✚ Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
 - ✚ Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.
 - ✚ Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.
 - ✚ Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësozin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.
 - ✚ Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.
 - ✚ Standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.
 - ✚ Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

**Funksionet e NJBSC janë
 shumë dimensionale dhe i
 shërbejnë parimeve të tilla si**

Mbështetje dhe sigurim i kërkimeve:

Anëtarët e NJSBC vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ana e tyre për të zhvilluar kërkime për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, kërkimet, në mënyrë shprehimore evoluojnë rreth zhvillimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë, duke vlerësuar përdorimin e mësimdhënies moderne, të mësuarit dhe metodat e vlerësimit të studentëve, me qëllim për të promovuar një qasje interaktive me studentin në qendër.

Koordinimi:

Meqënëse fakultetet, departamentet dhe njësitë e tjera janë të përfshira në rrjetin e sigurimit të cilësisë, NJSBC-ja koordinon proceset e vlerësimit të organizuar prej saj, p.sh. grumbullimi i të dhënave apo analizave. Interpretimi i detyrimeve kombëtare dhe evropiane për sigurimin e cilësisë: një nga detyrat e NSJBC-së është të interpretojë kriteret kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë për t'i përshtatur ato në kontekstin e Institucionit tonë. NJSBC-ja mundohet të sigurojë që këto detyrime kombëtare dhe evropiane të jenë pjesë e praktikës së punës dhe pjesë e jetës së KUQ.

Monitorimi:

Njësia harton udhëzime për mbikqyrjen, mbledh informacione, dhe ofron alternative për zgjidhjen e problemeve.

Administrimi:


Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në KUQ ka organizuar dhe hartuar një udhëzues procedural që përshkruan strukturën e institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë; specifikon kriteret për zgjedhjen dhe formatet e treguesve, standardet dhe objektivat; përgatit formatet standarde për çështje të tilla si sondazhe studentore, gjatë dhe pas studimeve universitare; si dhe këshillon për procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë; po ashtu mbledh sistematikisht dhe ruan raportet mbi ecurinë, përfshi të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen për analizat, si edhe raporton mbi prirjet në punë dhe ndryshimet në mjedisin institucional në të cilin vepron institucioni.

Facilitetet:

NJBSC-ja mundëson krijimin e një mjedisi të përqëndruar tek studenti, të favorshëm për një arsimim cilësor. Ajo mbështet përpjekjet për forcimin e personelit akademik dhe për të përvetësuar njohuritë dhe teknologjitë e kërkuara për pjesëmarrjen në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Sigurimi i informacionit mbi cilësinë:

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në KUQ merr përsipër shpërndarjen e informacionit mbi parametrat e ndryshëm të cilësisë së institucionit për palët e interesuara, të brendshme dhe të jashtme.



Treguesit kryesorë të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie ndër të tjera, përqendrohen tek:

a) Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies: kur matet cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, vëmendje të veçantë i është kushtuar aplikimit të mësimit interaktiv dhe metodat e mësimdhënies me në qendër studentin. Kjo përfshin ndërfitjen në mësimdhënie dhe mësimnxënie të elementeve që çojnë në formimin e aftësive të tilla tek studentët si: aftësia për të zgjidhur problemet, aftësia për të punuar në ekip, mënyra e duhur për të mësuar, përmirësimi i vazhdueshëm, përfitimi i njohurive ndërdisiplinore, ndërveprimi dhe përpunimi i informacionit, të mësuarit e teknologjive integrale, etj. Në këtë proces roli i lektorit është ai i një moderatori dhe/ose një udhërrëfyesi, dhe jo i një rrëfyesi.

b) Synimi i rezultateve të mësimnxënies dhe vlerësimit të studenteve: për të matur rezultatet e të mësuarit, vëmendje veçantë i kushtohet (a) mësimdhënies së njësuar dhe

përparimit të studenteve; (b) punësimit të të diplomuarve; (c) kualifikimit të pedagogëve dhe burimeve të mësimdhënies. Kur matet cilësia e mësimdhënies dhe e mësimnxënies, vëmendje e veçantë i kushtohet nxitjes së konceptit të "vlerësimit të mësimnxënies" si një qasje e vlerësimit të studentëve që nxit formimin e rezultateve të të nxënit për sa i përket njohurive, kompetencave dhe aftësive, jo thjesht vlerësimin e performancës së studentit.

c) **Rezultatet e arritura të të mësuarit:** për matjen e arritjes së rezultateve mësimore, pika kryesore është rishikimi i projekteve të pavarura të studentëve (detyra kursi, punime studimi, teza, etj).

d) **Përvoja e studentit:** për matjen e përvojës së studentit.

Në kuadër të zbatimit të vendimit të marë nga Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë për paraqitjen e një relacioni mbi zhvillimin e procesit mësimor akademik në auditor për të gjithë studentët që ndjekin studimet në Kolegjit Universitar "Qiriazi". Zbatimi i kriterëve të mësimdhënies është vënë nën monitorimin e menjëhershëm të zyrës së NJSBC. Në vijim do të gjeni relacione përmbledhëse mbështetur në raportimin që kanë bërë vetë lektorët e lëndëve përkatëse mbi gjendjen si dhe lëndët e zhvilluara sipas orarit mësimor të përcaktuar të Semestrit të II, viti akademik 2024-2025, në çdo fakultet.

Shtojca

RAPORT SEMESTRAL
(Shembull Orientues)

Lënda/Moduli:

Programi i Studimit:

Viti Akademik 2024-2025

Semestri :

Viti:

Pedagogu:

- Çfarë është trajtuar gjatë kursit? (shkurtimisht 200 fjalë)
- Trajtimi i lëndës përbushi qëllime dhe objektive kryesore? (shkurtimisht 200 fjalë).
- Si material bazë për zhvillimin e leksioneve u përdor literatura bashkohore vendase dhe e huaj.
- Gjatë zhvillimit të leksioneve, u aplikua metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit? (shkurtimisht 100 fjalë).
- Misioni dhe objektivat e programit të studimit për lëndën e (.....) janë të tilla që të japin dije aftësi dhe kompetenca të përshtatshme për kërkesat e tregut të punës: Lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar? (shkurtimisht 200 fjalë).

A. Ngarkesa mësimore

Nr	Lënda	Tema			Leksione	Seminare	Ushtrime	Arsyet e mosrealizimit
		Planifikuar	Realizuar	Parealizuar				

B. Frekuentimi i studentëve (në total dhe në përqindje) në leksione, seminare, praktika, kolokiume rezultoi:

Nr.:	Lënda	Leksione	Seminare	Kolokiume	Frekuentimi	
					Total studente	%
1.						

C. Kalueshmëria e studentëve në provime, kolokiume (në total dhe në përqindje).

Shëmbull: (Vlerësimi përfundimtar i lëndës me provim, u realizua në fund të kursit. Një Vlerësim i vazhdueshëm u bë në bazë të rezultateve të arritura në çdo diskutim, detyrë, temë apo

material të përgatitur nga studentët. Studentët janë informuar për strategjinë e vlerësimit që u përdor për programin e studimit, natyrën e provimit apo metodave të tjera të vlerësimit të cilave ju nënshtruan.)

Nr.	Lënda	Kolokiume		Provimi final Kalueshmëria në %
		I	II	
1.				

D. Analiza (SWOT) e pedagogut semestrit të dytë, të vitit akademik 2024-2025:

Pikat e Forta 1..... 2.....	Pikat e Dobëta 1..... 2.....
Mundësi dhe përmirësime 1..... 2.....	Kërcënime 1..... 2.....

E. Bashkangjitur lista e studentëve që dallohen për frekuentim

FAKULTETI I DREJTËSISË

Në zbatim të vendimeve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rregullores së saj dhe planit të veprimtarive të saj është këkuar nga çdo anëtar i stafit akademik të hartohet një **Raport Individual** mbi punën e kryer akademike.

Është zhvilluar mësimi dhe shkëmbimi i informacionit për çdo lëndë nga pedagogët përkatës sipas orarit mësimor të Sem.II, viti akademik 2024-2025.

Gjatë zhvillimit të leksioneve *sipas raportimeve*, u aplikua metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit. Është zhvilluar në mënyrë të rregullt mësimi në auditor me studentët e të gjitha viteve të studimit për çdo program studimi.

Pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor me studentët rezultoi që janë ruajtur standardet bazë të procesit të mësimdhënies dhe në bazë të vlerësimeve dhe verifikimeve të kryera standardet e respektuara, rezultuan të jenë:

- 1- Është realizuar një proces shpjegimi në auditor duke e shoqëruar me elementë të tjerë në formate powerpoint, excel, pdf, video.
- 2- Leksionet apo seminarët/ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara në planin mësimor.
- 3- Studentët kanë patur mundësi të kenë leksionet dhe të aksesojnë sipas mundësive të tyre fizike dhe teknologjike.

Bashkangjitur informacion më të detajuar


Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Kolegjit Universitar “QIRIAZI” me qëllim realizimin e misionit të tij ka realizuar në bashkëpunim me fakultetin e drejtësisë, departamentin “E drejtë civile dhe biznesi” dhe “E drejtë publike dhe penale” raportin për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025, mbi vlerësimin e procesit të brendshëm të cilësisë së programeve:

- Program i studimeve të integruar master i shkencave në drejtësi.
- Program i studimit 2 vjeçar me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”.

Pedagogët kanë plotësuar raportin semestral për realizimin e programeve të lëndëve. Për të analizuar cilësinë e realizimit është krahasuar syllabusi i modulit me raportin semestral të plotësuar nga pedagogu i lëndës. Për programin e studimeve të integruar master i shkencave në drejtësi raporti është plotësuar nga **71% e pedagogëve**. Për programin e studimeve 2 vjeçare me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ” është plotësuar **nga të gjithë pedagogët(100%)**.

Në këto raporte pasqyrohet përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës, pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor. Në javën e tetë sipas parashikimeve në shumicën e syllabuseve janë kryer teste të ndërmjetme lidhur me njohuritë e marra, gjë që i krijon mundësi studenteve të orientohen më mirë lidhur me kërkesat e lëndës dhe i bën ata më impenjativ në procesin e përvetësimit së njohurive. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium), e shprehur në përqindje, sipas programeve të studimit paraqitet nëpërmjetë grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 1. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium)



- Literatura e përdorur në zhvillimin e leksioneve.

Sikurse dhe duket nga raportet semestrale të paraqitura nga pedagogët, për zhvillimin e leksioneve është përdorur literature bashkëkohore vendase dhe e huaj. Literatura në disa lëndë që lidhen me legjislacionin shqiptar i pandryshuar daton në 1994 dhe shoqërohet me literaturë bashkëkohore e viteve të fundit deri në vitin 2022. Ciklet e leksioneve të pedagogut janë vendosur në dispozicion studentëve në formën hard copy. Krahas literaturës së detyrueshme pedagogët kanë përdorur edhe literatur ndihmëse, kryesisht në gjuhë të huaj për programin e ciklit të dytë.

- Plotësimi i objektivave dhe qëllimeve të punës.

Në çdo plan pune paraprakisht janë shënuar objektivat që pedagogu ka menduar të realizojë gjatë zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Nga raportet individuale vihet re se, pedagogët janë të kënaqur me realizimin e objektivave dhe qëllimeve të caktuara.

A. Ngarkesa mësimore.


Nga raportet, duket se procesi mësimor është realizuar plotësisht nga të gjithë pedagogët, lënda është zhvilluar në mënyrë interaktive me leksione, seminare ku ka patur dhe orë ushtrimesh që kanë ndikuar në përvetësimin me të mirë të teorisë. Temat janë realizuara 100%. Në rastet e tjera kur ditët e mësimit kanë qenë ditë feste zyrtare temat e mësimit janë zëvendësuar në orare të tjera kur është gjetur konsensusi midis të dy palëve, pedagogë- studentë.

B. Frekuentimi i studentëve (në total dhe në përqindje) në leksione, seminare, praktika dhe në provimin përfundimtar rezultoi:


Në grafikët e mëposhtëm paraqitet frekuentimi në përqindje për secilin program të ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë sipas Departamenteve.

Të dhënat janë përpunuar duke iu referuar raporteve semestrale të hartuara për secilën lëndë.

Grafiku 2 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin me karakter profesional “Asistent Ligjor dhe Administrativ”



Grafiku 3 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin e integruar Master i Shkencave në Drejtësi



C. Kalueshmëria e studentëve në provime, kolokiume (në total dhe në përqindje).

Në përfundim të lëndës është realizuar vlerësimi përfundimtar i lëndës nëpërmjet testit me shkrim ose me gojë. Performanca e studentëve vëzhgohet përmes vënies në funksion të një mekanizmi monitorues i cili konsiston në:

- Vijushmërin e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit praktik të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit.
- Testi ndërmjetëm
- Detyrën e kursit e cila synon të nxisë studentin të paraqes një analizë shkencore dhe mendim kritik mbi një tematik të caktuar.
- Testi përfundimtar, që zë % sipas syllabuseve.

Studentët janë informuar paraprakisht nga çdo pedagog, për mënyrën e vlerësimit që do të përdorej, numrin e testeve si dhe strukturën e detyrës së kursit që do të kryenin për secilën lëndë. Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut.

Përfundime:

- Frekuentimi i leksioneve në semestrin e dytë ka qenë mesatarisht 76%
- Frekuentimi i seminareve në semestrin e dytë ka qenë 78%
- Pjesëmarrja në kolokiume e studentëve ka qenë 72.3%
- Kalueshmëria e studentëve është 81.2%

Për sa i përket analizës SWOT dalim në përfundimin se pikat e forta ishin:

- Realizimi i objektivave të programit të lëndës në mënyrë të kënaqshme.
- Përdorimi dhe shfrytëzimi i literaturës jo vetëm të detyrueshme dhe asaj në gjuhën shqipe por edhe i literaturës bashkëkohore me tituj të huaj e të rëndësishëm për secilën prej fushave të studimit.
- Përditësimi me konceptet moderne të fushës së drejtësisë.
- Përdorimi i metodave interaktive me në qendër studentin.
- Gërshetimi i teorisë me praktikën.
- Angazhim maksimal me studentët.

Si pika të dobëta u evidentuan:

- Ngarkesa mësimore dhe mungesa e literaturës së viteve të fundit në gjuhën shqipe.
- Përfshirja në diskutim kryesisht e studentëve mbi mesatare.
- Bashkëpunimi me institucionet ligjore.

- Vështirësi në interpretimin e koncepteve juridike.
- Dorëzimi i detyrave dhe projekteve në kohë nga ana e studentëve.

Mundësi dhe përmirësime

- Gjetja e formave me motivuese për një frekuentim e përvetësim më të thellë të dijeve.
- Organizimi i leksioneve e seminareve edhe me ekspertë të fushës.
- Shkëmbimi i eksperiencave ndërkombëtare.
- Pasjen e një biblioteke online.
- Zhvillimi i më shumë rasteve praktike gjatë seminareve.

Kërcënime

- Numri i studentëve dhe pjesëmarrja.
- Niveli i ulët dhe dëshira për të studiuar dhe studiuar jashtë auditorit.
- Emigrimi masiv i moshave të reja duke ndërprerë studimet.
- Fokusimi te arsimit profesional duke shmangur studimet e larta

Ngarkesa të tjera¹

Nr.	Hartimi i tezës së provimit	Respektimi i orarit	Disiplina në punë	Plotësimi i regjistrit	Punë administrative
1.	Teza e provimit është hartuar nga pedagogët dhe aprovuar nga përgjegjësi i departamentit.	Orari është respektuar pjesërisht nga pedagogët.	Pedagogët e respektojnë kodin etik dhe rregulloren e institucionit.	Regjistrat janë plotësuar jo gjithmonë në kohë nga të gjithë pedagogët.	Pedagogët e këtij fakulteti janë të përfshirë në hartimin dhe rishikimin e rregullores së KUQ, fakultetit dhe departamenteve.

¹Kjo bëhet me qëllim evidentimin e ngarkesave të tjera që ju keni, angazhim në grupe të akreditimit, konferenca shkencore, leksione të hapura, projekte me studentët etj.

FAKULTETI I EKONOMISË

Në zbatim të vendimeve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rregullores së saj dhe planit të veprimtarive të saj është këkuar nga çdo anëtar i stafit akademik të hartohet një **Raport Individual** mbi punën e kryer akademike.

Është zhvilluar mësimi dhe shkëmbimi i informacionit për çdo lëndë nga pedagogët përkatës sipas orarit mësimor të Sem.II, viti akademik 2024-2025.

Gjatë zhvillimit të leksioneve *sipas raportimeve*, u aplikua metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit. Është zhvilluar në mënyrë të rregullt mësimi në auditor me studentët e të gjitha viteve të studimit për çdo program studimi.

Pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor me studentët rezultoi që janë ruajtur standardet bazë të procesit të mësimdhënies dhe në bazë të vlerësimeve dhe verifikimeve të kryera standardet e respektuara, rezultuan të jenë:

1. Është realizuar një proces shpjegimi në auditor duke e shoqëruar me elementë të tjerë në formate powerpoint, excel, pdf, video.
2. Leksionet apo seminarët/ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara në planin mësimor.
3. Studentët kanë patur mundësi të kenë leksionet dhe të aksesojnë sipas mundësive të tyre fizike dhe teknologjike.

Bashkangjitur informacion më të detajuar

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Kolegjit Universitar "QIRIAZI" me qëllim realizimin e misionit të tij ka realizuar në bashkëpunim me fakultetin e ekonomisë, departamentin "Financë" dhe "Menaxhim Biznesi" raportin për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025, mbi vlerësimin e procesit të brendshëm të cilësisë së programeve:


- Program i studimeve të ciklit të parë bachelor në Menaxhim Hoteleri Turizëm
- Program i studimeve të ciklit të parë bachelor në Menaxhim Biznesi
- Program i studimeve të ciklit të parë bachelor në Financë
 - Program i studimeve të ciklit të parë bachelor në Informatikë Ekonomike dhe Biznesi

Pedagogët kanë plotësuar raportin semestral për realizimin e programeve të lëndëve vetëm për katër programet e ciklit të parë **60.8% e pedagogëve**. ***Lidhur me programet e ciklit të dytë nuk janë dorëzuar raporte nga pedagogët përkatës.*** Për të analizuar cilësinë e realizimit është krahasuar syllabusi i modulit me raportin semestral të plotësuar nga pedagogu i lëndës.

Në këto raporte pasqyrohet përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës, pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor. Kryesisht në javën e tetë sipas parashikimeve në syllabus janë kryer

teste të ndërmjetme lidhur me njohuritë e marra, gjë që i krijon mundësi studenteve të orientohen më mirë lidhur me kërkesat e lëndës dhe i bën ata më impenjativ në procesin e përvetësimit së njohurive. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium), e shprehur në përqindje, sipas programeve të studimit paraqitet nëpërmjetë grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 1. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium)



- Literatura e përdorur në zhvillimin e leksioneve.

Sikurse dhe duket nga raportet semestrale të paraqitura nga pedagogët, për zhvillimin e leksioneve është përdorur literature bashkëkohore vendase dhe e huaj. Literatura në disa lëndë që lidhen me legjislacionin shqiptar i pandryshuar daton në 1973 dhe shoqërohet me literaturë bashkëkohore e viteve të fundit deri në vitin 2023. Vihet re se të ciklet e leksioneve të pedagogut janë vendosur në dispozicion studentëve në formën hard copy. Krahas literaturës së detyrueshme pedagogët kanë përdorur edhe literatur ndihmëse, kryesisht në gjuhë të huaj.

- Plotësimi i objektive dhe qëllimeve

Në çdo plan pune paraprakisht janë shënuar objektivat që pedagogu ka menduar të realizojë gjatë zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Nga raportet individuale vihet re se, pedagogët janë të kënaqur me realizimin e objektive dhe qëllimeve të caktuara.

A. Ngarkesa mësimore.


Nga raportet, duket se procesi mësimor është realizuar plotësisht nga të gjithë pedagogët, lënda është zhvilluar në mënyrë interaktive me leksione, seminare ku ka patur dhe orë ushtrimesh që kanë ndikuar në përvetësimin me të mirë të teorisë. Temat

janë realizuara 100%. Në rastet e tjera kur ditët e mësimit kanë qenë ditë feste zyrtare temat e mësimit janë zëvendësuar në orare të tjera kur është gjetur konsensusi midis të dy palëve, pedagogë- studentë.


B. Frekuentimi i studentëve (në total dhe në përqindje) në leksione, seminare dhe në provimin përfundimtar rezultoi:

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet frekuentimi në përqindje për secilin program të ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë. Të dhënat janë përpunuar duke iu referuar raporteve semestrale të hartuara për secilën lëndë.


Grafiku 2 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin bachelor “Menaxhim Hoteleri - Turizëm”




Grafiku 3 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin bachelor “Menaxhim Biznesi”



Grafiku 4 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin bachelor “Financë”.



Grafiku 5 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”



C. Kalueshmëria e studentëve në provime, kolokiume (në total dhe në përqindje).

Në përfundim të lëndës është realizuar vlerësimi përfundimtar i lëndës nëpërmjet testit me shkrim ose me gojë. Performanca e studentëve vëzhgohet përmes vënies në funksion të një mekanizmi monitorues i cili konsiston në:

- Vijushmërin e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit praktik të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit.
- Testi ndërmjetëm
- Detyrën e kursit e cila synon të nxisë studentin të paraqes një analizë shkencore dhe mendim kritik mbi një tematik të caktuar.
- Testi përfundimtar, që zë % sipas syllabuseve.

Studentët janë informuar paraprakisht nga çdo pedagog, për mënyrën e vlerësimit që do të përdorej, numrin e testeve si dhe strukturën e detyrës së kursit që do të kryenin për secilën lëndë. Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut.

Përfundime lidhur me ciklin e parë bachelor për katër programe:

- Frekuentimi i leksioneve në semestrin e dytë ka qenë mesatarisht 70.6%
- Frekuentimi i seminareve në semestrin e dytë ka qenë 79.7%
- Pjesëmarrja në kolokiume e studentëve ka qenë 82.49%
- Kalueshmëria e studentëve është 80.9%

Për sa i përket analizës SWOT pikat e forta ishin:

- Realizimi i objektivave të programit të lëndës në mënyrë të kënaqshme.
- Përdorimi dhe shfrytëzimi i literaturës jo vetëm të detyrueshme dhe asaj në gjuhën shqipe por edhe i literaturës bashkëkohore me tituj të huaj e të rëndësishëm për secilën prej fushave të studimit.
- Përdorimi i metodave interaktive me në qendër studentin.
- Angazhim maksimal me studentët.

Si pika të dobëta u evidentuan:

- Ngarkesa mësimore dhe mungesa e literaturës së viteve të fundit në gjuhën shqipe.
- Përfshirja në diskutim kryesisht e studentëve.
- Vështirësi në interpretimin e koncepteve abstrakte financiare dhe koncepteve juridike.
- Mosdorëzimi i detyrave dhe projekteve në kohë nga ana e studentëve.

Mundësi dhe përmirësime

- Gjetja e formave motivuese për një frekuentim e përvetësim më të thellë të dijeve.
- Organizimi i leksioneve e seminareve edhe me ekspertë të fushës.
- Pasjen e një biblioteke online.
- Zhvillimi i më shumë rasteve praktike gjatë seminareve.

Kërcënime

- Numri i studentëve dhe pjesëmarrja.
- Niveli i ulët dhe dëshira për të studiuar dhe studiuar jashtë auditorit.
- Emigrimi masiv i moshave të reja duke ndërprerë studimet.
- Fokusimi te arsimit profesional duke shmangur studimet e larta.

Ngarkesa të tjera¹

Nr.	Hartimi i tezës së provimit	Respektimi i orarit	Disiplina në punë	Plotësimi i regjistrat	Punë administrative
1.	Teza e provimit është hartuar nga pedagogët dhe aprovuar nga përgjegjësi i departamentit.	Orari është respektuar nga pedagogët.	Pedagogët e respektojnë kodin etik dhe rregulloren e institucionit.	Regjistrat janë plotësuar jo gjithmonë në kohë nga të gjithë pedagogët.	Pedagogët e këtij fakulteti janë të përfshirë në hartimin dhe rishikimin e rregullores së fakultetit dhe departamenteve.

Kjo bëhet me qëllim evidentimin e ngarkesave të tjera që ju keni, angazhim në grupe të akreditimit, konferenca shkencore, leksione të hapura, projekte me studentët etj

KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË

Në zbatim të vendimeve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rregullores së saj dhe planit të veprimtarive të saj është këkuar nga çdo anëtar i stafit akademik të hartohet një **Raport Individual** mbi punën e kryer akademike.

Është zhvilluar mësimi dhe shkëmbimi i informacionit për çdo lëndë nga pedagogët përkatës sipas orarit mësimor të Sem.II, viti akademik 2024-2025.

Gjatë zhvillimit të leksioneve *sipas raportimeve*, u aplikua metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit. Është zhvilluar në mënyrë të rregullt mësimi në auditor me studentët e të gjitha viteve të studimit për çdo program studimi.

Pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor me studentët rezulton që janë ruajtur standardet bazë të procesit të mësimdhënies dhe në bazë të vlerësimeve dhe verifikimeve të kryera standardet e respektuara, rezultuan të jenë:

1. Është realizuar një proces shpjegimi në auditor duke e shoqëruar me elementë të tjerë në formate powerpoint, excel, pdf, video.
2. Leksionet apo seminaret/laboratorët dhe ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara në planin mësimor.
3. Studentët kanë patur mundësi të kenë leksionet dhe të aksesojnë sipas mundësive të tyre fizike dhe teknologjike.

Bashkangjitur informacion më të detajuar

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Kolegjit Universitar “QIRIAZI” me qëllim realizimin e misionit të tij ka realizuar në bashkëpunim me KPL, departamentin “Teknologji Informacioni” dhe “Teknologji Ushqimore dhe Turizëm”, raportin për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025, mbi vlerësimin e procesit të brendshëm të cilësisë së programeve:


- Program i studimit 2 vjeçar me karakter profesional “Teknologji Informacioni”.
- Program i studimit 2 vjeçar me karakter profesional “Teknologji Ushqimore”.
- Program i studimit 2 vjeçar me karakter profesional “Hoteleri Turizëm”.

76 % e pedagogëve kanë plotësuar raportin semestral për realizimin e programeve të lëndëve. Për të analizuar cilësinë e realizimit është krahasuar syllabusi i modulit me raportin semestral të plotësuar nga pedagogu i lëndës.

Në këto raporte pasqyrohet përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës, pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor. Në javën e tetë sipas parashikimeve në syllabus janë kryer teste të

ndërmjetme lidhur me njohuritë e marra, gjë që i krijon mundësi studenteve të orientohen më mirë lidhur me kërkesat e lëndës dhe i bën ata më impenjativ në procesin e përvetësimit së njohurive. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium), e shprehur në përqindje, sipas programeve të studimit paraqitet nëpërmjetë grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 1. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium)



- Literatura e përdorur në zhvillimin e leksioneve.

Sikurse dhe duket nga raportet semestrale të paraqitura nga pedagogët, për zhvillimin e leksioneve është përdorur literature bashkëkohore vendase dhe e huaj. Literatura në disa lëndë që lidhen me legjislacionin shqiptar i pandryshuar daton në 1973 dhe shoqërohet me literaturë bashkëkohore e viteve të fundit deri në vitin 2023. Vihet re se të Ciklet e leksioneve të pedagogut janë vendosur në dispozicion studentëve në formën hard copy. Krahas literaturës së detyrueshme pedagogët kanë përdorur edhe literatur ndihmëse, kryesisht në gjuhë të huaj për programin e ciklit të dytë.

- Plotësimi i objektiveve dhe qëllimeve të punës.

Në çdo plan pune paraprakisht janë shënuar objektivat që pedagogu ka menduar të realizojë gjatë zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Nga raportet individuale vihet re se, pedagogët janë të kënaqur me realizimin e objektiveve dhe qëllimeve të caktuara.

A. Ngarkesa mësimore.


Nga raportet, duket se procesi mësimor është realizuar plotësisht nga të gjithë pedagogët, lënda është zhvilluar në mënyrë interaktive me leksione, seminare ku ka patur dhe orë ushtrimesh që kanë ndikuar në përvetësimin me të mirë të teorisë. Temat janë realizuara 100%. Në rastet e tjera kur ditët e mësimit kanë qenë ditë feste zyrtare

temat e mësimit janë zëvendësuar në orare të tjera kur është gjetur konsensusi midis të dy palëve, pedagogë- studentë.


B. Frekuentimi i studentëve (në total dhe në përqindje) në leksione, seminare, praktika dhe në provimin përfundimtar rezultoi:

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet frekuentimi në përqindje për secilin program të ofruar nga KPL. Të dhënat janë përpunuar duke iu referuar raporteve semestrale të hartuara për secilën lëndë.


Grafiku 2 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin me karakter profesional “Teknologji Informacioni”



Grafiku 3 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin me karakter profesional “Teknologji Ushqimore”



Grafiku 4 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin me karakter profesional “Hoteleri Turizëm”



C. Kalueshmëria e studentëve në provime, kolokiume (në total dhe në përqindje).

Në përfundim të lëndës është realizuar vlerësimi përfundimtar i lëndës nëpërmjet testit me shkrim ose me gojë. Performanca e studentëve vëzhgohet përmes vënies në funksion të një mekanizmi monitorues i cili konsiston në:

- Vijueshmërinë e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit praktik të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit.
- Testi ndërmjetëm
- Detyrën e kursit e cila synon të nxisë studentin të paraqes një analizë shkencore dhe mendim kritik mbi një tematik të caktuar.
- Testi përfundimtar, që zë % sipas syllabuseve.

Studentët janë informuar paraprakisht nga çdo pedagog, për mënyrën e vlerësimit që do të përdorej, numrin e testeve si dhe strukturën e detyrës së kursit që do të kryenin për secilën lëndë. Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut.

Përfundime:

- Frekuentimi i leksioneve në semestrin e dytë ka qenë mesatarisht 69.3%
- Frekuentimi i seminareve në semestrin e dytë ka qenë 87.5%
- Pjesëmarrja në kolokiume e studentëve ka qenë 91.2%
- Kalueshmëria e studentëve është 90.96%

Lidhur me analizën SWOT pikat e forta ishin:

- Realizimi i objektivave të programit të lëndës në mënyrë të kënaqshme.
- Përdorimi dhe shfrytëzimi i literaturës jo vetëm të detyrueshme dhe asaj në gjuhën shqipe por edhe i literaturës bashkëkohore me tituj të huaj e të rëndësishëm për secilën prej fushave të studimit.

- Përdorimi i metodave interaktive me në qendër studentin.
- Gërshetimi i teorisë me praktikën.
- Angazhim maksimal me studentët.

Si pika të dobëta u evidentuan:

- Ngarkesa mësimore dhe mungesa e literaturës së viteve të fundit në gjuhën shqipe.
- Përfshirja në diskutim kryesisht e studentëve mbi mesatar
- Vështirësi në interpretimin e koncepteve juridike për programet dy vjeçare.
- Dorëzimi i detyrave dhe projekteve në kohë nga ana e studentëve.

Mundësi dhe përmirësime

- Gjetja e formave me motivuese për një frekuentim e përvetësim më të thellë të dijeve.
- Organizimi i leksioneve e seminareve edhe me ekspertë të fushës.
- Shkëmbimi i eksperiencave ndërkombëtare.
- Pasjen e një biblioteke online.
- Zhvillimi i më shumë rasteve praktike gjatë seminareve.

Kërcënime

- Numri i studentëve dhe pjesëmarrja.
- Niveli i ulët dhe dëshira për të studiuar dhe studiuar jashtë auditorit.
- Emigrimi masiv i moshave të reja duke ndërprerë studimet.
- Fokusimi te arsimit profesional duke shmangur studimet e larta.

Ngarkesa të tjera¹

Nr.	Hartimi i tezës së provimit	Respektimi i orarit	Disiplina në punë	Plotësimi i regjistrimit	Punë administrative
1.	Teza e provimit është hartuar nga pedagogët dhe aprovuar nga drejtuesit e departamenteve.	Orari është respektuar kryesisht nga pedagogët.	Pedagogët e respektojnë kodin etik dhe rregulloren e institucionit.	Regjistrat janë plotësuar jo gjithmonë në kohë nga të gjithë pedagogët.	Pedagogët e KPL janë të përfshirë në hartimin dhe rishikimin e rregullores së KPL dhe departamenteve.

Kjo bëhet me qëllim evidentimin e ngarkesave të tjera që ju keni, angazhim në grupe të akreditimit, konferenca shkencore, leksione të hapura, projekte me studentët etj.

FAKULTETI I EDUKIMIT SHKENCAVE SOCIALE DHE SPORTIT

Në zbatim të vendimeve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rregullores së saj dhe planit të veprimtarive të saj është këkuar nga çdo anëtar i stafit akademik të hartohet një **Raport Individual** mbi punën e kryer akademike.

Është zhvilluar mësimi dhe shkëmbimi i informacionit për çdo lëndë nga pedagogët përkatës sipas orarit mësimor të Sem.II, viti akademik 2024-2025.

Gjatë zhvillimit të leksioneve *sipas raportimeve*, u aplikua metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit. Është zhvilluar në mënyrë të rregullt mësimi në auditor me studentët e të gjitha viteve të studimit për çdo program studimi.

Pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor me studentët rezulton që janë ruajtur standardet bazë të procesit të mësimdhënies dhe në bazë të vlerësimeve dhe verifikimeve të kryera standardet e respektuara, rezultuan të jenë:

1. Është realizuar një proces shpjegimi në auditor duke e shoqëruar me elementë të tjerë në formate powerpoint, excel, pdf, video.
2. Leksionet apo seminarët/modulet dhe ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara në planin mësimor.
3. Studentët kanë patur mundësi të kenë leksionet dhe të aksesojnë sipas mundësive të tyre fizike dhe teknologjike.

Bashkangjitur informacion më të detajuar

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Kolegjit Universitar “QIRIAZI” me qëllim realizimin e misionit të tij ka realizuar në bashkëpunim me FESHSS, departamentin “Edukim fizik dhe Sporte” dhe “Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv” raportin për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025, mbi vlerësimin e procesit të brendshëm të cilësisë së programeve:

- Program i studimit të ciklit të parë bachelor “Edukim Fizik dhe Sporte”.
- Program i studimit 2 vjeçar me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”.

Raporti nuk përmban të dhëna pasi raporti i pedagogëve është dorëzuar vetëm nga 21.05 % e tyre, duke i bërë gjetjet jo relevante.

Raporti është realizuar vetëm për programin profesional dy vjeçar “Kujdes Social dhe Shëndetësor” ku kanë sjellë raportin 55.5% e pedagogëve. Për të analizuar cilësinë e realizimit është krahasuar syllabusi i modulit me raportin semestral të plotësuar nga pedagogu i lëndës.

Në këto raporte pasqyrohet përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës, pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor. Në javën e tetë sipas parashikimeve në syllabuse janë kryer teste të ndërmjetme lidhur me njohuritë e marra, gjë që i krijon mundësi studenteve të orientohen më mirë lidhur me kërkesat e lëndës dhe i bën ata më impenjativ në procesin e përvetësimit së njohurive. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm (kolokium), e shprehur në përqindje, sipas programeve të studimit paraqitet nëpërmjetë grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 1. Pjesëmarrja e studentëve në testin e ndërmjetëm(kolokium)



- Literatura e përdorur në zhvillimin e leksioneve.

Sikurse dhe duket nga raportet semestrale të paraqitura nga pedagogët, për zhvillimin e leksioneve është përdorur literature bashkëkohore vendase dhe e huaj. Literatura në disa lëndë që lidhen me legjislacionin shqiptar i pandryshuar daton në 1973 dhe shoqërohet me literaturë bashkëkohore e viteve të fundit deri në vitin 2023. Vihet re se të Ciklet e leksioneve të pedagogut janë vendosur në dispozicion studentëve në formën hard copy. Krahas literaturës së detyrueshme pedagogët kanë përdorur edhe literatur ndihmëse, kryesisht në gjuhë të huaj për programin e ciklit të dytë.

- Plotësimi i objektivave dhe qëllimeve të punës.

Në çdo plan pune paraprakisht janë shënuar objektivat që pedagogu ka menduar të realizojë gjatë zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Nga raportet individuale vihet re se, pedagogët janë të kënaqur me realizimin e objektivave dhe qëllimeve të caktuara.


A. Ngarkesa mësimore.

Nga raportet, duket se procesi mësimor është realizuar plotësisht nga të gjithë pedagogët, lënda është zhvilluar në mënyrë interaktive me leksione, seminare ku ka patur dhe orë ushtrimesh që kanë ndikuar në përvetësimin me të mirë të teorisë. Temat janë realizuara 100%. Në rastet e tjera kur ditët e mësimit kanë qenë ditë feste zyrtare temat e mësimit janë zëvendësuar në orare të tjera kur është gjetur konsensusi midis të dy palëve, pedagogë- studentë.

B. Frekuentimi i studentëve (në total dhe në përqindje) në leksione, seminare, praktika dhe në provimin përfundimtar rezultoi:

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet frekuentimi në përqindje për secilin program të ofruar nga KPL. Të dhënat janë përpunuar duke iu referuar raporteve semestrale të hartuara për secilën lëndë.

Grafiku 2 Të dhëna mbi frekuentimin e leksioneve, seminareve, provimit përfundimtar për programin me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”



C. Kalueshmëria e studentëve në provime, kolokiume (në total dhe në përqindje).

Në përfundim të lëndës është realizuar vlerësimi përfundimtar i lëndës nëpërmjet testit me shkrim ose me gojë. Performanca e studentëve vëzhgohet përmes vënies në funksion të një mekanizmi monitorues i cili konsiston në:

- Vijueshmërin e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit praktik të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit.
- Testi ndërmjetëm
- Detyrën e kursit e cila synon të nxisë studentin të paraqes një analizë shkencore dhe mendim kritik mbi një tematik të caktuar.
- Testi përfundimtar, që zë % sipas syllabuseve.

Studentët janë informuar paraprakisht nga çdo pedagog, për mënyrën e vlerësimit që do të përdorej, numrin e testeve si dhe strukturën e detyrës së kursit që do të kryenin për secilën lëndë. Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut.

Përfundimet nuk janë për fakultetin ESHSS, por programi:

- Frekuentimi i leksioneve në semestrin e dytë ka qenë mesatarisht 82.6%
- Frekuentimi i seminareve në semestrin e dytë ka qenë 85.6%%
- Pjesëmarrja në kolokiume e studentëve ka qenë 95.6%
- Kalueshmëria e studentëve është 96.6%

Për sa i përket analizës SWOT *pikat e forta* ishin:

- Realizimi i objektivave të programit të lëndës në mënyrë të kënaqshme.
- Përdorimi dhe shfrytëzimi i literaturës dhe pajisja e studentëve me materiale shtesë
- Përdorimi i metodave interaktive me në qendër studentin.
- Trajtim i teknikave praktike të ndërhyrjes.

Si pika të dobëta u evidentuan:

- Mungesa e literaturës së viteve të fundit në gjuhën shqipe.
- Përfshirja në diskutim kryesisht e studentëve
- Zgjidhja e rasteve konkrete.

Mundësi dhe përmirësime

- Organizimi i leksioneve e seminareve edhe me ekspertë të fushës.
- Pasjen e një bibliotekës me literaturën përkatëse.
- Infrastruktura online.
- Përmirësim i programeve lëndore

*** Kërcënime**

- Numri i studentëve dhe pjesëmarrja.
- Niveli i ulët dhe dëshira për të studiuar dhe studiuar jashtë auditorit.
- Emigrimi masiv i moshave të reja duke ndërprerë studimet.

Ngarkesa të tjera¹

Nr.	Hartimi i tezës së provimit	Respektimi i orarit	Disiplina në punë	Plotësimi i regjistrit	Punë administrative
1.	Teza e provimit është hartuar nga pedagogët dhe aprovuar nga drejtuesit e departamenteve.	Orari është respektuar nga të gjithë pedagogët.	Pedagogët e respektojnë kodin etik dhe rregulloren e institucionit.	Regjistrat janë plotësuar relativisht në kohë nga të gjithë pedagogët.	Pedagogët e ESHSRS janë të përfshirë në hartimin dhe rishikimin e rregullores së fakultetit dhe departamenteve.

Kjo bëhet me qëllim evidentimin e ngarkesave të tjera që ju keni, angazhim në grupe të akreditimit, konferenca shkencore, leksione të hapura, projekte me studentët etj.